



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

RREGULLORE

Nr. 01, Datë 04.11. 2014

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN
NR.79, DATË 16.04.2010 “PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË PROKURORISË””**

Me synimin, rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e funksionimit të Këshillit të Prokurorisë në lidhje me promovimin, emërimin dhe transparencën e tij;

Pasi, u mor mendimi i Këshillit të Prokurorisë,

Në mbështetje, të neneve 12, 20 e 43 të ligjit nr 8737, datë 12.2.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;

Në Rregulloren nr.79, datë 16.04.2010 *“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Prokurorisë”* bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas neni 1 shtohet neni 1/a me këtë përmbajtje:

“Neni 1/a

Përbërja e Këshillit të Prokurorisë

1. Këshilli i Prokurorisë përbëhet nga shtatë anëtarë, nga të cilët gjashtë prokurorë dhe një përfaqësues i Ministrit të Drejtësisë. Në mbledhjen e këshillit mund të marrë pjesë edhe një përfaqësues i Presidentit të Republikës.

2. Prokurorët, anëtarë të Këshillit të Prokurorisë, duhet të kenë mbi pesë vjet pune si prokurorë.

3. Përbërja e këshillit duhet të jetë si më poshtë:

- a) tre prokurorë, që ushtrojnë funksionet në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë;
- b) dy prokurorë, që ushtrojnë funksionet në prokuroritë pranë gjykatave të apeleve;
- c) një prokuror, që ushtron funksionet në Prokurorinë e Përgjithshme.

4. Në Këshillin e Prokurorisë nuk mund të zgjidhen ose të jenë anëtarë prokurorët, ndaj të cilëve është dhënë ose jepet masë disiplinore.”

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Komisioni i verifikimit të dokumentacionit

1. Këshilli i Prokurorisë, në mbledhjen e parë të çdo viti të ri kalendarik, zgjedh me shumicë votash, Komisionin për verifikimin e përmbushjes së kriterëve ligjore të kandidatëve për t’u emëruar prokuror, ngritur në detyrë, transferuar, caktuar drejtues dhe zëvendës drejtues.

2. Komisioni përbëhet nga dy anëtarë të Këshillit përfaqësues të prokurorisë dhe një punonjës i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, i caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

3. Komisioni, brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit për depozitimin e kërkesave, harton dhe përfaqësuesi/punonjësi i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore paraqet me shkrim përpara këshillit relacionin me të dhëna të verifikuara, i cili duhet të përmbajë domosdoshmërisht:

3.1 Listën e kandidatëve që përmbushin kriteret ligjore për çdo vend vakant të shpallur, me të dhënat si vijon:

- a) gjeneralitetet e kandidatit;
- b) rezultatet e përfundimit të studimeve universitare dhe/ose pasuniversitare;
- c) treguesit dhe eksperiencën në punë;
- ç) trajnime ose specializime të ndryshme;
- d) të dhëna në fushën e publikimeve;
- dh) të dhëna për masa disiplinore;
- e) të dhëna për aftësitë profesionale dhe etiko-morale;
- ë) për kandidatët që konkurojnë për prokurorë dhe kryejnë detyrën e oficerit të policisë gjyqësorë, duhet të paraqitet edhe mendimi për vlerësimin e punës nga drejtuesi i prokurorisë ku ushtron funksionet;
- f) për kandidatët prokurorë që konkurojnë për ngritje në detyrë duhet të paraqiten dhe vlerësimet e punës në dy herët e fundit.

3.2 Listën e kandidatëve dhe përshkrimin e shkakut/shkaqeve që ai/ata nuk i përmbush/in kriteret ligjore për emërimin në vendin/et e shpallura vakant.”

Neni 3

Pas nenit 3 shtohen neni 3/a, neni 3/b dhe neni 3/c me përmbajtjet, si më poshtë:

“Neni 3/a

Shqyrtimi në Këshill

1. Këshilli i Prokurorisë, në mbledhje të veçantë njihet dhe vlerëson relacionin e Komisionit të verifikimit.

2. Për kandidaturat që parashikon neni 18 i ligjit nr.8737/2001 (i ndryshuar), të cilët plotësojnë kriteret për t’u emëruar prokuror, Këshilli organizon konkurimin me shkrim sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të Prokurorit të Përgjithshëm dhe seancën dëgjimore të tyre.

3. Për kandidaturat që plotësojnë kriteret ligjore për ngritje në detyrë dhe drejtues prokurorie, krahas konkurimit mbi bazë dokumentash, këshilli organizon seancën dëgjimore të tyre.

4. Këshilli jep mendimin e tij për kandidatët, duke e shoqëruar me vlerësimin e marrë nga secili prej tyre në konkurim.”

“Neni 3/b

Vlerësimi i kandidaturave për ngritje në detyrë

1. Këshilli i Prokurorisë vlerëson çdo kandidaturë për ngritje në detyrë sipas kriterëve të mëposhtme:

- | | |
|-----------------------------------|----------|
| a) vjetërsia si prokuror, deri në | 25 pikë; |
| b) vlerësimet e punës, deri në | 45 pikë; |
| c) veprimtaria akademike, deri në | 10 pikë; |
| ç) seanca dëgjimore, deri në | 20 pikë. |

2. Këshilli jep mendimin e tij për kandidatët duke e shoqëruar me vlerësimin e marrë nga secili prej tyre në konkurim.”

“Neni 3/c

Këshilli i Prokurorisë jep mendim për emërimin e kandidatëve të sapo diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës pas zhvillimit të seancave dëgjimore, duke i vlerësuar secilin në raport me specifikat e vendeve të shpallura vakant dhe nevojat e prokurorive.”

Neni 4

Në nenin 9, pika 1, paragrafi i katërt, pas fjalës “sekretari” shtohet fjala “teknik”.

Neni 5

Pas neni 10 shtohen neni 10/a, neni 10/b, neni 10/c, neni 10/ç dhe neni 10/d me përmbajtjet, si më poshtë:

“Neni 10/a

Plani vjetor i inspektimeve dhe tematika e tyre

1. Në muajin dhjetor të çdo viti, Këshilli i Prokurorisë merr në shqyrtim propozimin e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore për planin vjetor të inspektimit dhe tematikën e tij.

2. Këshilli jep mendimin e tij lidhur me planin vjetor të inspektimeve, duke marrë në konsideratë dhe problematikat e konstatuara prej tij gjatë vitit të fundit.”

“Neni 10/b

Shqyrtimi i raportit të inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë

1. Këshilli merr në shqyrtim, raportin e inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë për inspektimet e kryera në prokurori dhe relacionin e inspektimit verifikues të kryer mbi këtë raport nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore.

2. Këshilli brenda një kohe të arsyeshme i jep Prokurorit të Përgjithshëm mendimin e tij të arsyetuar lidhur me këtë raport dhe rekomandimet përkatëse.”

“Neni 10/c

Shqyrtimi i projekt akteve normative

1. Këshilli i Prokurorisë shqyrton çdo projekt akt normativ (rregullore, urdhër, udhëzim) që njeh të drejta dhe përcakton detyra për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.

2. Projekt akti diskutohet dhe votohet në parim, nen për nen dhe në tërësi.

3. Këshilli i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm, mendimin e tij shoqëruar me sygjerimet përkatëse.”

“Neni 10/ç

Këshilli i propozon Prokurorit të Përgjithshëm, masa për organizimin e brendshëm dhe miradministrimin e prokurorisë apo përmirësimin e legjislacionit në fushën penale.”

“Neni 10/d

Këshilli shqyrton dhe jep mendim për unifikimin e politikës së ndjekjes penale, në hetim dhe gjykim. Në këtë rast zbatohet për sa është e mundur procedura e parashikuar për shqyrtimin e projekt akteve normative.”.

Neni 6

Në nenin 11, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Në mungesë të kryetarit, mbledhja drejtohet nga prokurori me përvojën më të madhe si anëtar i Këshillit, dhe nëse të gjithë anëtarët kanë të njëjtën vjetërsi në Këshill, mbledhja drejtohet nga anëtari me vjetërsinë më të madhe si prokuror.”

Neni 7

Në nenin 12, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet në: **“Thirrja e mbledhjes”**.

2 Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4.1. Mbledhjet e Këshillit të Prokurorisë janë të hapura, përveçse kur Këshilli me shumicë votash vendos ndryshe.”

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ADRIATIK LLALLA